



## **SYLLABUSI I LËNDËS “PROGRAMIMI I ORIENTUAR NË OBJEKTE”**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>			
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike		
<b>Titulli i lëndës:</b>	Programimi i orientuar në objekte		
<b>Programi:</b>	Dizajnimi i Softuerëve		
<b>Niveli:</b>	Baçelor		
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative		
<b>Viti i studimeve:</b>	2		
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2 (ligjërata dhe ushtrime)		
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	6 ECTS		
<b>Koha / lokacioni:</b>	Të publikuara në web site të universitetit!		
<b>Mësimdhënësit e lëndës:</b>	Prof. Asoc. Dr. Ercan Canhasi Ass. Arta Misini, Ph. D. c.		
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	ercan.canhasi@uni-prizren.com arta.misini@uni-prizren.com		
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Ky kurs prezanton konceptet e avancuara të programimit. Temat përfshijnë trajtimin e përjashtimeve, fajllat hyrës – dalës, klasat dhe objektet, trashëgimia dhe kompozimi, polimorfizmi, interfejsat dhe klasat abstrakte.		
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	Kjo është lënda e dytë e programimit në shkenca kompjuterike. Kjo është lëndë mbi konceptet e avancuara të programimit në kompjuter për studentët që kanë përvojë programimi. Qëllimi është që studentët të mësojnë të shkruajnë programe në gjuhën programuese Java, gjithnjë duke vënë theksin në principet e programimit.		
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	Pas përfundimit të kësaj lëndë studenti do: <ul style="list-style-type: none"><li>• Të kuptojnë natyrën e “object oriented” programimit.</li><li>• Të kuptojnë strukturat e avancuara të gjuhëve programuese.</li><li>• Të mësojnë të shfrytëzojnë konceptet e avancuara të programimit.</li><li>• Të njoftohen me kompleksitetin e metodologjive për zgjidhjen e problemeve nga fusha e programimit të orientuar në objekte.</li></ul>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	1	1	1
Kollokfiime, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	2	4



Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	6	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj	4	2	8
<b>Totali</b>			<b>150 orë (6 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Lënda është kombinim i ligjëratave, diskutimeve, ushtrimeve numerike dhe laboratorike, ndërsa detyrat prezantohen nga asistenti në laborator.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vijueshmëria në ligjërata dhe ushtrime: 5% + 5%.</li> <li>• Testi i parë: 45%</li> <li>• Testi i dytë: 45%</li> <li>• Ose provimi përfundimtar: 100%.</li> </ul>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	1. P.Deitel and H.Deitel. (2012). Java: How to Program (9th edition). Prentice Hall.		
<b>Literatura shtesë:</b>	2. Bruce Heckel. Thinking in Java (5th edition). 3. Ivor Horton. Beginning Java 2, JDK (5th edition).		

<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	Retro shikimi ne zhv.Soft I	Hyrje
<i>Java e dytë:</i>	Menaxhimi i gabimit dhe debug	Trajtimi i përjashtimeve
<i>Java e tretë:</i>	Fajllat, rrjedhja hyrje / dalje	Fajllat, rrjedhja hyrje / dalje
<i>Java e katërt:</i>	Fajllat, rrjedhja hyrje / dalje	Fajllat, rrjedhja hyrje / dalje
<i>Java e pestë:</i>	Klasat, objektet dhe metodat	Klasat, Objektet dhe metodat
<i>Java e gjashtë:</i>	Klasat, objektet dhe metodat	Klasat, Objektet dhe metodat
<i>Java e shtatë:</i>	Klasat, objektet dhe metodat	Klasat, Objektet dhe metodat
<i>Java e tetë:</i>	Testi i parë	Ushtrime për testin e parë
<i>Java e nëntë:</i>	Trashëgimia	Trashëgimia
<i>Java e dhjetë:</i>	Kompozimi	Kompozimi
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Polimorfizmi	Polimorfizmi
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Polimorfizmi	Polimorfizmi
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Ndërfaqet	Ndërfaqet (rast studimi: Databases)
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Klasat abstrakte	Klasat abstrakte (rast studimi: Card Players)
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi i dytë	Ushtrime për testin e dytë
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		



- Në përgjithësi prezantimet e ligjëratave do të bëhen përmes MS PowerPoint, tabelës, përdorimit të materialeve, programeve kompjuterike dhe ushtrimeve numerike.
- Po ashtu, nga mësimdhënësit do të sigurohen edhe materiale tjera shtesë (punime shkencore, publikime, buletinet nacionale, si dhe zbulimet dhe hulumtimet e fundit).
- Në mungesë të mundësisë që puna praktike të organizohet çdo javë, në bashkëpunim me menaxhmentin e universitetit, ky aktivitet do të organizohet në ditë të caktuara në: organizata, kompani, njësitë prodhuese-përpunuese, etj.
- Gjatë çdo seancë do të organizohet qasja e bashkëbisedimit dhe bashkëparticipimit me studentë!
- Nga studentët kërkohet që të jenë të rregullt në ligjëratat dhe ushtrimet!
- Do të vlerësohet kontributi i studentëve kur ata bashkëpunojnë dhe participojnë në ligjëratat dhe ushtrimet e lëndës!
- Ardhja e studentëve me kohë në ligjëratat dhe ushtrimet është e obligueshme!